



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJEN VENDORE

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

**TAKIMI I GRUPIT TEKNIK TË PUNËS SË PERFORMANCËS LIDHUR ME
TREGUESIT E PERFORMANCËS 2024 NË FUSHËN E PYJEVE, KULLOTAVE DHE
MENAXHIMIT TE MBETJEVE**

Tiranë, 10 Prill 2025

Hapja e mbledhjes

Mbledhjen e hapi *Z. Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar, AMVV*, duke falenderuar pjesëmarrësit dhe theksuar rëndësinë e sigurimit të të dhënave cilësore dhe të matshme për performancën e bashkive. Menaxhimi i mbetjeve dhe administrimi i pyjeve janë dy funksionet më të rëndësishme të nivelit vendor. Administrimi i pyjeve u transferua në bashki që prej vitit 2016 dhe ende ka nevojë për përmirësime në mbledhjen e të dhënave dhe raportimin në këtë fushë. Në fushën e menaxhimit të mbetjeve, theksoi sfidat si kostot e larta dhe mbulimin jo të plotë të territorit, analiza e të cilave është shumë e nevojshme për ndërhyrje të koordinuara në përmirësim e qëndrueshëm.

Çështje të diskutuara

Znj. Olta Caca, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës dhe Performancës, AMVV prezantoi rezultatet e SMP 2023 në lidhje me këto fusha, i cili shoqërohet për herë të parë me një publikim të dedikuar. Ky publikim përfshin 40 tregues të ndarë sipas tematikave përkatëse.

Në kuadër të këtij procesi, një nga treguesit e analizuar ishte:

“Shkalla e pajisjes me Plane Mbarështimi”

Nga vetë-raportimi i bashkive në sistemin e matjes së performancës rezulton se 5 bashki kanë një përqindje të konsiderueshme të sipërfaqes së pyjeve të pajisur me plane mbarështimi. Megjithatë, të dhënat tregojnë se rreth 2/3 e bashkive nuk disponojnë asnjë plan mbi ekonominë pyjore. Për më tepër, vetëm 19% e sipërfaqes së pyjeve dhe kullotave, që përfaqësojnë rreth 1.4 milion hektarë, janë të mbuluara me plane mbarështimi.

Ky tregues theksoi nevojën për t’u fokusuar më tepër në hartimin e planeve të mbarështimit dhe shtroi idenë e krijimit të një skeme incentivimi, ku bashkitë që realizojnë planet sipas kriterëve të përcaktuara, do të kenë mundësi të përfitojnë bonus. Kjo qasje synon të nxisë angazhimin e bashkive për të përmirësuar performancën në administrimin e burimeve pyjore në mënyrë të qëndrueshme dhe të strukturuar.

Komente:

Z. Ilir Bala, Drejtor, AKP ngriti shqetësimin se në bashkinë Sarandë nuk ka plane të menaxhimit/mbarështimit për pyjet, ndryshe nga ç’kanë raportuar bashkitë.

Znj. Voltana Ademi, Ekspert, Smart Processes u shpreh se mund të ketë një proces inventarizimi që është interpretuar si plan menaxhimi/mbarështimi pyjesh.

Znj. Ornela Shapo, Ekspert, Shapo Consulting vlerësoi këtë situatë si një gjetje me rëndësi, duke theksuar se vetë-deklarimet nga bashkitë nuk janë gjithmonë të sakta dhe prandaj nevojitet verifikimi dhe bashkërendimi me të dhënat nga ministritë.

Treguesi i dytë i fushës së pyjeve dhe kullotave i pandryshuar nga SMP 2023:

“Punonjës për 1000 hektarë”.

Nga të dhënat rezulton se në shumicën e bashkive ky tregues është në nivele të ulëta, ç’ka tregon një mungesë të fuqisë punëtore për të mbuluar dhe menaxhuar në mënyrë efektive sipërfaqet pyjore. Një rast për t’u theksuar ishte ai i bashkisë Kamëz, e cila, pavarësisht se ka një sipërfaqe të vogël pyjore, ka një numër relativisht të lartë punonjësish në këtë sektor, në krahasim me bashkitë e tjera. Ky shembull nxjerr në pah dallimet ndërmjet bashkive dhe nevojën për rishikimin e burimeve njerëzore në përputhje me sipërfaqet që administrojnë.

Diskutime mbi dy treguesit:

Z. Bala theksoi se mungesa e punonjësve për administrimin e pyjeve nuk është vetëm një çështje statistikore, por një problem me shumë dimensione. Ai identifikoi disa arsye kryesore: mungesa e vëmendjes nga njësitë e qeverisjes vendore, që shpesh nuk e konsiderojnë këtë sektor si prioritet, dhe zbatimi i procesit të decentralizimit të pyjeve pa një analizë të plotë mbi kostot dhe efektet ekonomike. Ai theksoi se pyjet u transferuan në bashki pa mbështetje të mjaftueshme në burime njerëzore dhe kapacitete teknike.

Znj. Shapo u shpreh mbi rëndësinë e matjes së performancës, duke vlerësuar se treguesit aktualë janë të vlefshëm për t’u ruajtur edhe për vitin 2024.

Z. Llavdaniti theksoi se, në lidhje me treguesin mbi planet e mbarështimit të pyjeve, është e rëndësishme të krijohen mekanizma që nxisin angazhimin real të bashkive. Ai vuri në dukje se përfshirja e këtij treguesi në grantin e performancës, përfaqëson një mënyrë për të ushtruar tryzni pozitive ndaj njërive të qeverisjes vendore. Një bashki mund të përfitojë deri në 23 mijë euro nëse arrin të përmbushë kriteret për planin e menaxhimit pyjor, në varësi të zhvillimit të ekonomisë pyjore.

Z. Bala rikujtoi një aspekt të rëndësishëm të kuadrit ligjor, duke theksuar se bashkitë kanë detyrimin që të ardhurat e gjeneruara nga fondi pyjor t’i rikthejnë 100% po në fondin pyjor.

Znj. Shapo ngriti pyetjen nëse janë transferuar edhe asetet digjitale, inventarët dhe hartat lidhur me administrimin e pyjeve.

Z. Ylli Hoxha, Përgjegjës, MTM sqaroi se, në procesin e transferimit të pyjeve, është bërë një transferim i fondit pyjor në letra, por pa një inventar konkret të aseteve dhe burimeve pyjore. Ai theksoi se, megjithëse janë dorëzuar dokumentet përkatëse, gjendja e aseteve nuk ka pasur përputhshmëri me realitetin në momentin e dorëzimit.

Znj. Shapo ngriti pyetjen se, përveç faktit që bashkitë duhet të nxiten të hartojnë plane menaxhimi, a është e domosdoshme që ato të bëjnë një inventarizim të plotë të aseteve pyjore dhe kullimore?

Z. Hoxha sqaroi se ekzistojnë kriteret dhe një metodologji e qartë për kryerjen e planeve të menaxhimit pyjor. Ai theksoi se procesi i hartimit të këtyre planeve është i strukturuar, që garanton përputhshmërinë me standardet dhe kërkesat teknike.

Z. Bernard Shalca, Përgjegjës, INSTAT theksoi se, në bashkëpunim me SALSTAT, merren të dhëna nga bashkitë për pyjet dhe një problem i dukshëm është mungesa e stafit.

Z. Llavdaniti theksoi se të dy treguesit janë të rëndësishëm, pasi ata do të ndikojnë pozitivisht në planin e mbarështimit, duke i ndihmuar bashkitë të organizojnë më mirë punën e tyre dhe gjithashtu të gjenerojnë të ardhura.

Znj. Ademi u interesua në lidhje me një projekt të Bankës Botërore, ku është punuar për hartimin e hartave digjitale për inventarizimin dhe regjistrimin e pyjeve. Ajo kërkoi informacion mbi rezultatet e këtij projekti dhe nëse ka pasur implementim të tij në bashki.

Z. Hoxha sqaroi se projekti i Bankës Botërore është tashmë i realizuar dhe është përfunduar faza e regjistrimit të pyjeve në të gjithë vendin. Ai shtoi se, treguesi kryesor është punonjës pyjesh për 1000 hektarë, pasi ai reflekton drejtëpërdrejtë kapacitetin e administratës pyjore dhe mundësinë e përmbushjes së detyrave të menaxhimit të pyjeve.

Znj. Caca iu drejtua INSTAT, lidhur me pilotimin e procesit të regjistrimit dhe menaxhimit të pyjeve, duke kërkuar të dinte nëse ky pilotim është realizuar në të gjitha bashkitë e vendit, apo në disa të zgjedhura, dhe si ka ndikuar kjo në mbledhjen e të dhënave për pyjet.

Z. Shalca sqaroi se pilotimi është realizuar në 10 bashki, në bazë të një draft pyetësori që ai vetë ka hartuar, i cili përmban 40 pyetje të ndara sipas sektorëve. Ai theksoi se, në përgjigje të këtyre pyetjeve, planet e mbarështimit rezultuan me mungesa në plotësimin e tyre, dhe një mungesë e dukshme e stafit ka ndikuar në përmbushjen e detyrave të menaxhimit pyjor.

Pas këtyre diskutimeve, *Znj. Caca* vijoi me prezantimin e mbetjeve. Ajo theksoi se mesatarisht 68% e kostove për menaxhimin e mbetjeve mbulohen nga tarifat e shërbimit, ndërkohë që kostoja mesatare për mbledhjen e një ton mbetjesh llogaritet rreth 8,830 lekë. Nga kategorizimi i bashkive sipas metodologjisë, rezulton se bashkitë më të vogla raportojnë një nivel më të ulët mbulimi të kostove, mesatarisht rreth 45%, duke reflektuar sfidat më të mëdha që ato përballojnë në administrimin e shërbimit si pasojë e mungesës së infrastrukturës së zhvilluar, si dhe kapaciteteve të kufizuara njerëzore dhe teknike. Në lidhje me gjenerimin e mbetjeve, gjatë vitit 2023 në Shqipëri janë mbledhur rreth 835,000 ton mbetje, me një gjenerim mesatar për frymë prej 348 kg në vit.

1. Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit;

Znj. Caca theksoi se, sipas të dhënave të vitit 2023, Berati dhe Mati kanë arritur të rikuperojnë kostot për menaxhimin e mbetjeve nga tarifa e shërbimit duke rritur të ardhurat e veta, si dhe Devolli, Bulqiza, Lushnja dhe Kuçova kanë siguruar mbulim të plotë të kostove (100%). Ndërkohë, disa bashki raportojnë mbulim nën 50%. Rasti i Tropojës u përmend si problematikë për shkak të mospërputhjeve në të dhëna, çka ka sjellë përjashtimin nga analiza, duke u shoqëruar me shënime sqaruese në raport.

2. Mbetjet e gjeneruara si kg/banor;

3. Kosto për ton në lekë.

Komente:

Znj. Shapo theksoi rëndësinë e treguesit të gjenerimit të mbetjeve, duke vënë në pah vështirësitë e hasura në sigurimin e të dhënave të sakta. Ajo sqaroi se matja e këtij treguesi është kryer dy herë, për të garantuar besueshmëri dhe rezultatet e nxjerra kanë qenë në përputhje të ngushtë me të dhënat e publikuara nga AKM, çka forcon besueshmërinë e analizës.

Z. Dhimitraq Prishka, Drejtor, AKEM ngriti shqetësimin lidhur me saktësinë e të dhënave, duke vënë në dukje se në disa raste janë raportuar norma të gjenerimit të mbetjeve tepër të larta, konkretisht shifra prej 0.9 kg/banor konsideruar e lartë për realitetin vendas. Ai sqaroi se në vendet e zhvilluara kjo normë është zakonisht më e lartë, ndërkohë që në vendet më pak të zhvilluara pritet që norma e gjenerimit të mbetjeve të jetë më e ulët.

Z. Shalca sqaroi se në lidhje me të dhënat për mbetjet është kryer përpunim dhe trajtim shtesë, si pasojë e problemeve të konstatuara në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të raportuara nga bashkitë.

Znj. Caca iu drejtua përfaqësuesve të INSTAT lidhur me llogaritjen e mbulimit të popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve, duke kërkuar sqarime mbi metodologjinë dhe burimet e përdorura për këtë tregues, me qëllim rritjen e transparencës dhe krahasueshmërisë së të dhënave ndër-institucionale.

Z. Shalca sqaroi se shkalla e mbulimit të popullsisë nga shërbimi i menaxhimit të mbetjeve merret përmes pyetësorëve të dërguar bashkive. Ata theksuan se të dhënat raportohen bazuar në popullsinë rezidente, dhe jo sipas regjistrave zyrtarë të bashkive, me qëllim që vlerësimi të jetë sa më afër realitetit të shërbimit të ofruar në terren.

Znj. Caca theksoi se ka pasur një përpunim dhe pastrim të të dhënave më të detajuar nga ana e ekipit, më shumë se në çdo fushë tjetër, për shkak të karakteristikave të veçanta të të dhënave mbi mbulimin e shërbimit. Ajo shpjegoi se të dhënat për mbulimin i referohen popullsisë së regjistruar në gjendjen civile dhe gjatë analizës janë vërejtur mospërputhje në disa bashki, të cilat kërkuar verifikim të mëtejshëm dhe pastrim.

Znj. Shapo sugjeroi që në metodologjinë e ardhshme të ndahet raportimi për **zonat urbane dhe rurale**, për të pasur një pasqyrë më të qartë dhe të saktë të mbulimit të shërbimit.

Z. Shalca theksoi se në pyetësorin e tyre kërkojnë të dhëna mbi menaxhimin e mbetjeve, por problemi kryesor është **ndarja e të dhënave**. Gjithashtu, theksoi se ndarja sipas zonave urbane dhe rurale në menaxhimin e mbetjeve ka rëndësi. Për më tepër, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) përdor të njëjtin pyetësor si INSTAT për të mbledhur këto të dhëna.

Znj. Kuzumi theksoi një problematikë, bashkitë raportojnë të dhëna me metodologji të ndryshme për institucione të ndryshme dhe kjo mund të çojë në keq interpretime si dhe raportime të pasakta.

Përfaqësuesit e *AKEM* sqaruan se është duke u krijuar një sistem i unifikuar nga AKSHI, ku të gjitha të dhënat do të aksesohen në varësi të përdoruesit, për të siguruar një menaxhim më të efektshëm dhe të standardizuar të informacionit.

Znj. Marsela Sina, Oficere projekti, FLAG sugjeroi që treguesi “Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve” të formulohet në përputhje me termin që përdoret në strategjinë kombëtare për menaxhimin e integruar të mbetjeve, për të siguruar harmonizimin dhe standardizimin e të dhënave.

Përfundime

Në fund të takimit u kërkua dakordësimi i anëtarëve të grupit të punës, lidhur me treguesit e propozuar për SMP 2024, si më poshtë:

Fusha e Pyjeve dhe Kullotave:

- 1. Shkalla e pajisjes me plane mbarështimi pyjesh;**
- 2. Punonjës pyjesh për 1000 hektarë;**

Fusha e Menaxhimit të Mbetjeve:

- 1. Mbulimi i popullsisë me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve në zonat urbane/rurale;**
- 2. Mbulimi i kostos së menaxhimit të mbetjeve nga tarifa e shërbimit;**
- 3. Mbetjet e gjeneruara si kg/banor;**
- 4. Kosto për ton në lekë;**
- 5. Plani Vendor i Menaxhimit të Mbetjeve.**

Të gjithë anëtarët e grupit të punës ranë dakord me propozimin.